



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK Nr.1, TIRANË

Nr 1047 Prot

Tiranë më 29.09.2025

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJEREZORE
DREJTORISË SË MARREDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBETARE TË PUNESIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”; të udhëzimit nr. 759, datë 30.9.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, ofruesi publik i AFP-së, **Qendra e Formimit Profesional Publik nr. 1, Tiranë**, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin Specialist jurist/burime njerëzore.

Pozicioni

-Specialist jurist/burime njerëzore – 1 person.

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vend të lirë pune si vijon:

1. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
2. të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
3. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
4. të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
5. të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
6. të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit;

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

1. Të ketë të paktën nivelin arsimor Bachelor në shkenca shoqërore/juridike për shpalljen e pozicionit përkatës.
2. Të ketë të paktën 1 (nje) vit përvojë pune sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës;
3. Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

II. DOKUMENTET E APLIKIMIT

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

1. letërmotivimin për pozicionin;
2. jetëshkrimin (CV-në);
3. kartën e identitetit;
4. diplomën;
5. Librezën e punës;
6. çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
7. certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
8. vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
9. vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
10. vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
11. -të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës
08.10.2025.

